



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA

Tiranë, më 07.03.2019

### Raport Vjetor

#### “Mbi ecurinë e punës së kryer nga Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda për vitin 2018”

I. Bërja e analizës së punës për vitin 2018, është një moment shumë i rëndësishëm pasi na jep mundësinë që të pasqyrojmë gjithë aktivitetin një vjeçar të punës së Prokurorisë së Apelit Për Krime të Rënda Tiranë. Që në hyrje të kësaj analize dua të theksoj se ky vit ka qenë një vit shumë i ngarkuar për Prokurorët të cilët kanë përballuar një ngarkesë të madhe, kjo dhe për faktin se gjatë vitit 2018 ka patur numër të reduktuar Prokurorësh. Sjell në vëmendje se kemi të bëjmë jo vetëm me numër të madh çështjesh të trajtuara, por edhe me kategori çështjesh shumë komplekse dhe me numër të madh të pandehurish. Një ngarkesë e tillë ka kërkuar angazhim maksimal të secilit Prokuror.

Ndryshimet që ju bënë Kodit të Procedurës Penale, me Ligjin nr.35/2017, bënë të nevojshme që Prokurorët të tregoheshin të kujdesshëm në zbatimin me korrektësi të instituteve të reja procedurale si dhe në vlerësimin e drejtë të ndryshimeve që pësuan dispozita të shumta procedurale.

Gjatë ushtrimit të funksionit, Prokurorët e Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, kanë qenë të vetëdijshëm se nuk është i mjaftueshëm vetëm karakteri institucional dhe kuadri ligjor, por edhe përkushtimi total për kryerjen dhe zotërimin e detyrës, duke ju nënshtruar vetëm ligjit.

Pozitën procedurale të posaçme të prokurorit si mbrojtës i akuzës në ushtrimin e detyrës, nuk e kemi parë të shkëputur në raport me ligjshmërinë dhe zgjidhjen në themel të çështjes, me qëllim dhënien e një vendimi të drejtë sipas ligjit material dhe procedural, duke respektuar të drejtat e individit dhe në pajtim me Kushtetutën.

Sfidë më vetë ka qenë organizimi dhe shpërndarja e punës në Prokurori e diktuar nga ndryshimet e mëdha që solli miratimi i paketës së reformës në drejtësi. Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda ka marrë gjithë masat e nevojshme që

ngarkesa mes prokurorëve të jetë pothuajse e njëjtë, me qëllim që nga ana e Prokurorëve të bëhet një përfaqësim sa më i denjë. Konkluzionet para Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda janë paraqitur gjithmonë me shkrim dhe kjo jep mundësinë për një kontroll dhe transparencë më të madhe. Prokurorët kanë respektuar datën dhe orën e gjykimit duke mos u bërë shkak për shtyrje të seancave gjyqësore.

Një mbështetje e madhe për Prokurorët ka qenë administrata e Prokurorisë së Apelit Për Krime të Rënda, e cila ka treguar angazhim maksimal në mbështetje të Prokurorëve me qëllim krijimin e lehtësirave dhe infrastrukturës së nevojshme.

**II.** Për të qenë më konkret më poshtë do të analizojmë me detaje treguesit sasiorë dhe cilësorë të Prokurorisë së Apelit Për Krime të Rënda, Tiranë. Duke ju referuar treguesve statistikorë, rezulton se për periudhën që analizojmë, nga kjo Prokurori është përfaqësuar akuza për **344** çështje gjyqësore, me **226** të pandehur, nga të cilat për **114** çështje kanë gjetur zgjidhje themeli, **59** çështje shqyrtimi të masave të sigurimit dhe **171** çështje të veçanta.

Është ushtruar **rekurs** në Gjykatën e Lartë për **36** çështje themeli dhe **1** recurs për masë sigurimi.

Lidhur me volumin e punës për secilin prokuror paraqitet:

- Prokurori **A. BAJRAMI** ka përfaqësuar **62** çështje themeli, **30** masa sigurimi dhe çështje të veçanta **74**, gjithsej **166** çështje penale.

- Prokurori **B. SHESHI** ka përfaqësuar **52** çështje themeli, **22** masa sigurimi dhe **56** çështje të veçanta, gjithsej **130** çështje penale

- Prokurore **B. Nikhasani** ka përfaqësuar **0** çështje themeli, **6** masa sigurimi, **3** çështje të veçanta, gjithsej **9** çështje penale

- **38** çështje të veçanta janë trajtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë në Dhomë Këshillimi.

- **1** çështje masë sigurimi është trajtuar nga Gjykata po në dhomë këshillimi

Gjatë përfaqësimit në gjykatë, janë bërë të gjitha përpjekjet për të luajtur një rol aktiv në funksion të mbrojtjes së akuzës, pas një studimi e verifikimi të gjithanshëm të materialeve të çështjes gjyqësore e hetimit paraprak si dhe atyre të paraqitura nga palët. Kjo pozitë e posaçme e prokurorit nuk është detyruese, kur nga aktet e çështjes duket qartë dhe kemi arritur në përfundimin se vendimi është i padrejtë dhe i pabazuar në prova, pavarësisht nga qëndrimi që ka mbajtur prokurori i shkallës së parë, është kërkuar cënimi i këtij vendimi.

Në shqyrtimin gjyqësor të çështjeve të ardhura me ankimin e të pandehurve, duke e konsideruar si vazhdim gjykimi, jemi përqëndruar në deklarimin fajtor, kualifikimin ligjor, llojin dhe masën e dënimit, me arsyetimin e shkaqeve ligjore të zgjidhjes së drejtë të çështjes në themel nga gjykata e shkallës së parë e në respektim të ligjit material dhe procedural. Nuk kemi asnjë rast vonese apo të mosparaqitjes së prokurorit në seancë gjyqësore, që të shërbejë si shkak për shtyrjen e gjykimit.

Në parim, argumentet në konkluzionet me shkrim janë përqëndruar në funksion të shqyrtimit gjyqësor të realizuar në shkallë të parë, në karakterin bindës, në analizën dhe çmuarjen e provave, në themel të të cilit të ketë përputhje me materialin provues, rrethanat e faktit dhe mbi këtë bazë të hidhen poshtë kontestimet e mbrojtjes.

**III.** Gjatë vitit 2018 në Prokurorinë e Apelit për Krime të Rënda janë shqyrtuar 114 çështje themeli, të cilat përfshijnë veprat penale si më poshtë:

- 67 çështje për krimin e “Trafikimit të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i K.Penal,

-14 çështje penale për veprën penale të “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, parashikuar nga neni 109/b/1 i K.Penal.

-2 çështje për veprën penale të “Vrasje me paramendim”, parashikuar nga neni 78/2 i K.Penal.

- 12 çështje penale për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79/c i K.Penal.

- 3 çështje penale për veprën penale të “Trafikimi i personave të rritur” parashikuar nga neni 110/a/2 i K.Penal

- 1 çështje penale për veprën penale të “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal

3- çështje penale për veprën penale të “Trafikimi i të miturve”, parashikuar nga neni 128 i K.Penal

- 1 çështje penale për veprën penale të “ Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i K.Penal

- 1 çështje për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

- 1 çështje penale për veprën penale të “ Kundërshtimi i punonjësit të policisë”, parashikuar nga 236 i K.Penal

-2 çështje penale për veprën penale të “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror”, parashikuar nga 260 i K.Penal

- 1 çështje penale për veprën penale “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthese e municioneve”, parashikuar nga 278 i K.Penal

- 1 çështje penale për veprën penale të “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufinjëve”, parashikuar nga neni 298 i K.Penal.

-5 çështje për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 284 i K.Penal.

Nga evidenca e mësipërme konstatohet se pjesa kryesore e veprave penale është ajo e “Trafikimit të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283 i K.Penal, “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 79/c i K.Penal si dhe “Shtrëngimi me

anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”,parashikuar nga neni 109/b/1 i K.Penal.

E kemi konsideruar se nuk është e mjaftueshme vetëm deklarimi fajtor e kualifikimi ligjor, por edhe dhënia e një mase të drejtë dënimi në raport me veprën e kryer, autorin dhe rrethanat e kryerjes së saj. Në këtë këndvështrim, kërkesat e prokurorit të shkallës së parë dhe vendimet e gjykatës kanë rezultuar të bazuara në prova e në ligj dhe si të tilla, janë mbështetur nga ana jonë dhe janë pranuar nga Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda.

**III.1.** Mbi bazën e ankimit të Prokurorit, janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Për Krime të Rënda 5 çështje, nga të cilat:

- 2 ankime të Prokurorit kishin objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda,në lidhje me kualifikimin e gabuar ligjor. Nga këto 2 ankime vetëm një është pranuar nga Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda.

-2 ankime të Prokurorit kishin për objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës në lidhje me masën e dënimit të caktuar ndaj të pandehurve. Nga këto 2 ankime vetëm një është pranuar nga Gjykata, ndërsa për një tjetër është shpallur moskompetenca lëndore.

- Në një rast, Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda ka hequr dorë nga ankimi i Prokurorit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Gjykatën e Apelit Për Krime të Rënda, prokurorët e apelit kanë bërë të gjithë përpjekjet në funksion të bindjes së Gjykatës që të pranonte ankimet e bëra. Siç dhe më lart prezantova vetëm për dy ankime Gjykata e Apelit i ka pranuar kërkesat e Prokurorit. Më konkretisht çështjet e ardhura mbi bazën e ankimit të Prokurorit janë si më poshtë:

a- Çështja në ngarkim të të pandehurit **E. H** ka ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë, për ndryshimin e pjeshëm të vendimit Nr.108, datë 09.11.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e cila ka vendosur aplikimin e nenit 59 të K.Penal, për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b/1 të K.Penal.

Gjykata e Apelit me vendimin Nr.06, datë 11.01.2018, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Pare për Krime të Rënda, duke e ndryshuar këtë të fundit dhe mos pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim.

b. Çështja në ngarkim të të pandehurve **L.T, M.S, M.S, A. S, M.K, D.T, E. T e J. M**, ka ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë, për pjesën që ka vendosur pushimin e akuzave, ndryshimin e kualifikimit ligjor për të pandehurit L.T, M.S e M.S, të vendimit Nr.23, datë 07.03.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Gjykata e Apelit me vendimin Nr.59, datë 11.06.2018 ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda **duke pranuar** apelin e prokurorit.

**Nga Kolegji Gjyqësor i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, nuk është pranuar apeli i prokurorit gjatë gjykimit për dy çështje**

a. Çështja penale në ngarkim të të pandehurit **J.D**, ka ardhur me ankim të prokurorit të shkallës së parë për ndryshimin e vendimit Nr.86, datë 18.07.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila ka ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës së parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal duke e cilësuar sipas nenit 300 të K.Penal.

Prokurori i Apelit ka përkrahur apelin e prokurorit të shkallës së parë dhe ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi. Gjykata e Apelit **nuk e pranoi apelin** e prokurorit dhe me vendimin Nr.85, datë 29.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Prokurori B.Sheshi **ka ushtruar Rekurs** në Gjykatën e Lartë.

b. Çështja në ngarkim të të pandehurve **E.K** dhe **E. C** ka ardhur mbi bazën e ankimit të prokurorit të shkallës së parë, për ndryshimin e vendimit Nr.106, datë 08.11.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kjo Gjykatë ka ulur masën e dënimit të kërkuar nga Prokuroria me 30 vjet burgim në 20 vjet burgim, për të pandehurin **E. K**, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/a e 22,88/1,278/1 dhe 279/2 të K.Penal

Prokurori i Apelit ka përkrahur apelin e prokurorit të shkallës së parë dhe ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi. Gjykata e Apelit me vendimin Nr.39, datë 26.03.2018 ka vendosur konstatimin e moskompetencës lëndore dhe prishjen e vendimit Nr.106, datë 08.11.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Prokurori A. Bajrami **ka ushtruar Rekurs** në Gjykatën e Lartë.

### **III.2. Prokurorët e Apelit kanë hequr dorë nga ankimi i Prokurorit të shkallës së parë në 1 rast si më poshtë:**

- Çështja në ngarkim të të pandehurit **H.Sh**, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/c ,284/1,137 dhe 280 të Kodit Penal, ka ardhur **me ankim të prokurorit** të shkallës së parë i cili ka kërkuar dënimin me 20 vjet burgim.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.43, datë 22.05.2017, ka zbutur dënimin ndaj këtij të pandehuri, duke aplikuar nenin 23 të K.Penal pasi ka vlerësuar se plotësohen kushtet që parashikon kjo dispozitë,për faktin se vepra ka mbetur në tentative .Kjo gjykatë e ka dënuar përfundimisht të pandehurin H. Sh me 12 vjet burgim.

Duke e konsideruar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda si të drejtë, Prokuroria e Apelit ka deklaruar para Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda se hiqte dorë nga ankimi.

Gjykata e Apelit me vendimin Nr.15, datë 22.01.2018, ka lenë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**III.3.** Gjatë shqyrtimit të çështjeve mbi bazën e ankimit të të pandehurve janë cënuar nga Gjykata e Apelit 31 vendime nga të cilat: 4 çështje për kualifikim ligjor, 17 çështje masë sigurimi, 4 çështje për pafajësi dhe 4 çështje kthim për rigjykim. Një panoramë më e plotë në lidhje me këtë vendimmarrje të Gjykatës është si më poshtë:

1- Çështja në ngarkim të të pandehurit **E.Z**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1, 22 të Kodit Penal ka ardhur me ankim të të pandehurit.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.102, datë 07.11.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe ka ulur masën e dënimit nga 6 vjet 4 muaj burgim në 5 vjet e 4 muaj burgim. Prokurori A.Bajrami ka vlerësuar se diferenca në masë dënimi mes asaj të kërkuar nga Prokurori dhe asaj të dhënë nga Gjykata nuk është e madhe dhe ndaj nuk ka ushtruar rekurs.

2- Çështja në ngarkim të të pandehurit **E.M**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1, 22 të Kodit Penal ka ardhur me ankim të të pandehurit.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.97, date 25.10.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe ka ulur masën e dënimit nga 4 vjet burgim në 3 vjet e 4 muaj burgim. Prokurori A.Bajrami ka vlerësuar se diferenca e viteve të dënimit është e vogël dhe nuk duhet ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

3. Çështja në ngarkim të të pandehurve **B.H e L.L**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1, 22 dhe 300 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.92, datë 17.10.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin për të pandehurin B. H dhe ka ulur masën e dënimit nga 6 vjet e 8 muaj burgim në 5 vjet e 4 muaj burgim. Prokurori A. Bajrami ka vlerësuar se diferenca e viteve të dënimit është e vogël dhe nuk duhet ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

4. Çështja në ngarkim të pandehurit **G.Q**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2, 22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.114, datë 31.11.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe e ka **kthyer çështjen për rigjykim** në Gjykatën Shkallës së Parë.

5. Çështja në ngarkim të pandehurit **L. B**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b/1 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit. Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.58, datë 13.06.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila e ka dënuar të pandehurin me 2 vjet e 3 muaj burgim.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe e ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin, “pasi nuk provohet që i pandehuri ta ketë kryer veprën penale”.

Prokurori B.Sheshi, **ka ushtruar Rekurs** në Gjykatën e Lartë kundër këtij vendimi.

6. Çështja në ngarkim të të pandehurit **L.R**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2,22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.119, datë 14.12.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe ka ulur masën e dënimit në aplikim të nenit 22 dhe 23/2 të Kodit Penal, nga 6 vjet e 8 muaj burgim në 5 vjet e 4 muaj burgim.

Prokurori A. Bajrami ka vlerësuar se diferenca e viteve të dënimit është e vogël dhe nuk duhet ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi.

7. Çështja në ngarkim të të pandehurit **Dh.K**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2,22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.124, datë 24.12.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe ka ulur masën e dënimit, në aplikim të nenit 22 dhe 23/2 të Kodit Penal, nga 2 vjet e 8 muaj burgim në 1 vjet e 6 muaj burgim.

Prokurori A.Bajrami ka vlerësuar se nuk ka shkaqe për të ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi.

8. Çështja në ngarkim të të pandehurit **E.Ç**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2,22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.06, datë 18.01.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin për fajësinë dhe për cilësimin juridik të vepres penale,por ka ndryshuar masën e dënimit duke e ulur nga 11 vjet burgim në 10 vjet burgim dhe ka pranuar aplikimin e gjyqimit të shkurtuar, aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale.

9. Çështja në ngarkim të të pandehurve **Rr. S, A.K e A.K**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/4, 22 dhe 300 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.120, datë 15.12.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën Shkallës së Parë.

Prokurori B. Sheshi ka ushtruar **Rekurs** kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë,dhe kërkon :Prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda nga i njëjti trup gjykues, meqenëse nuk rezulton që kjo gjykatë të jetë shprehur për themelin

10. Çështja në ngarkim të të pandehurve **L.N, L.N, B.B, E.H, S.B, H.N,A.T,A. Xh e B.H**, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 284/1, 28/4,333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.29, datë 16.03.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë dhe ka pushuar akuzën në lidhje me aplikimin e nenit 333/1 të K.Penal ,për të pandehurit L.N, L.N, E.H, S.B, A.Xh, A.T dhe jep pafajësi për tre të pandehurit B.B , H.N dhe B.H, për nenin 333/a/1 dhe 334 të Kodit Penal.

Prokurori B.Sheshi ka ushtruar **Rekurs** kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë.

**11.** Çështja në ngarkim të të pandehurve **M. L,A.B, D.S dhe B.D**, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b/1,333/a/1 dhe 334/1,2831 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.62, datë 26.06.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë, duke ulur masën e dënimit për të pandehurit

Prokurori A. Bajrami ka vlerësuar se diferenca e viteve të dënimit është e vogël dhe nuk ka shkaqe për të ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

**12.** Çështja në ngarkim të të pandehurve **B. Z, P. R,F.R e G.A**, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 284/1, 28/4,333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve,.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.63, datë 09.05.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin për fajësinë dhe masat e dënimit dhe ka pushuar akuzën në lidhje me aplikimin e nenit 333/1 të K.Penal.

Prokurori B. Sheshi nuk ka ushtruar rekurs pasi nuk është cënuar vendimi për fajësinë dhe masën e dënimit.

**13.** Çështja në ngarkim të të pandehurit **A. Z**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 260 dhe 25 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.70, datë 19.09.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe e ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin Artur Zoto dhe ka urdhëruar lirim të menjëhershëm të tij.

Prokurori A. Bajrami ka ushtruar **Rekurs** në Gjykatën e Lartë.

**14.** Çështja në ngarkim të të pandehurit **A.D**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1,22 të Kodit Penal,ka ardhur me ankim të të pandehurit.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.71, datë 25.06.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe ka ulur masën e dënimit nga 10 vjet burgim në 8 vjet burgim.

Prokurori B. Sheshi ka vlerësuar se nuk ka shkaqe për të ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

**15.** Çështja në ngarkim të të pandehurve **K. Z e F.H**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2,22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.73, datë 25.06.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin në lidhje me cilësimin juridik të veprës, për të pandehurin F. H duke e cilësuar sipas nenit 300 të K.Penal,dhe në masë dënimi për të pandehurin K.Z.



Prokurori A.Bajrami nuk ka ushtruar Rekurs për këtë çështje.

**16.** Çështja në ngarkim të të pandehurve **G.LI, I.A, A.T,A.T,V.B**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2,22 të Kodit Penal dhe **M. S, J.M e G.B**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 300 të Kodit Penal, ka ardhur nga Gjykata e Lartë.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr.122 datë 19.12.2017, ka shpallur moskompetencën lëndore si gjykatë jo kompetente për gjykimin e çështjes...."kjo çështje duhej të gjykohej nga gjykata e nivelit të zakonshëm, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Kundër vendimit nr.122 datë 19.12.2017, të Gjykatës së Apelit, ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë.

Gjykata e Lartë ka vendosur "Dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, për vazhdimin e gjykimit që ka kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes".

Gjatë rigjykimit, prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit për tre të pandehurit A.T , M. S dhe V.B ka urdhëruar lirimin e tyre,pasi është konstatuar se ky dënim është vuajtur me qëndrimin në paraburgim.

**17.** Çështja në ngarkim të të pandehurve **Sh.Xh,B.B e M.V**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2,22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.07, datë 22.01.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin duke i deklaruar të pandehurit të pafajshëm, pasi nuk provohet fajësia e tyre.

Prokurori B.Sheshi ka ushtruar **Rekurs** kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë.

**18.** Çështja në ngarkim të të pandehurve **T.D e F.Z**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 391/ç dhe 391 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.88, datë 26.07.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin për të pandehurin T.D dhe e ka deklaruar fajëtor për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

Prokurori B.Sheshi ka ushtruar **Rekurs** kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë.

**19.** Çështja në ngarkim të të pandehurit **K.D**, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 134/1,22,333/a/1 e 334 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.91, datë 11.09.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka lënë në

fuqi vendimin për fajësinë dhe masat e dënimit dhe ka pushuar akuzën në lidhje me aplikimin e nenit 333/1 të K.Penal.

Prokurori B. Sheshi nuk ka ushtruar rekurs pasi nuk është cënuar vendimi për fajësinë dhe masën e dënimit.

**20.** Çështja në ngarkim të të pandehurit **L.I**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1,22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit,

Nga prokurori është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.106, datë 11.10. 2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe ka ulur masën e dënimit në aplikim të nenit 23 të Kodit Penal, nga 4 vjet 8 muaj burgim në 4 vjet burgim.

Prokurori A.B, ka vlerësuar se nuk ka shkaqe për të ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi.

**21.** Çështja në ngarkim të të pandehurve **F.A, A.C**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1,22 të Kodit Penal e **F.H**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.12, datë 05.02.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe ka ulur masat e dënimit për të pandehurit, duke aplikuar nenin 406 të K.Pr.Penale.

Prokurori B. Sheshi ka vlerësuar se nuk ka shkaqe për të ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi.

**22.** Çështja në ngarkim të të pandehurve **A.A,A.A,B.B, E.B, E.K,Xh.M, K.S, O.P, D.G, R.H e I.Xh**, akuzuar për veprat penale të parashikuar nga nenet 79/b e 22,334/1,278 të K.Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve.

Gjykata eShkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin e saj ndër të tjera ka vendosur dënimin e të pandehurit **A. A** me 20 vjet burgim dhe **E.K** me 18 vjet burgim.

Nga prokurori i apelit është kërkuar:1. lënia në fuqi e vendimit Nr.33, datë 21.03.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, 2.Ndryshimin e masës së dënimit për të pandehurit **A.A** e **E.K** duke i dënuar secilin prej tyre me një dënim përfundimtarë prej vetëm 12 vjet burgim, pasi janë minorenë.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin për masën e dënimit për dy të pandehurit **A.A** e **E.K**, duke i dënuar më 17 vjet e 6 muaj burgim dhe ka lënë në fuqi vendimin për të pandehurit e tjerë.

**23.** Çështja në ngarkim të të pandehurve **E. A e P.P**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b/1,25 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.95, datë 21.09.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin në lidhje me mënyrën e vuajtjes së dënimit duke aplikuar nenin 59 të K.Penal, për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.

Prokurori B.Sheshi nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

24. Çështja në ngarkim të të pandehurve **R.M e B.I**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2,22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve,

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr.13 datë 19.01.2018, ka shpallur moskompetencën lëndore si gjykatë jo kompetente për gjykimin e çështjes..."kjo çështje duhej të gjykohej nga gjykata e nivelit të zakonshëm, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër. Kundër vendimit ka ushtruar Rekurs, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë.

Gjykata e Lartë ka vendosur: "Dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda për vazhdimin e gjykimit që ka kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes".

Gjatë rigjyimit, nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin në lidhje me mënyrën e vuajtjes së dënimit duke aplikuar nenin 59 të K.Penal, për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim,për të pandehurin B.I.

Prokurori A. Bajrami ka ushtruar **Rekurs** kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë,dhe kërkon :Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në këtë Gjykatë.

25 Çështja në ngarkim të të pandehurit **A.Z**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1,22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.97, datë 24.09.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe ka ulur masën e dënimit në aplikim të nenit 23 te Kodit Penal.

Prokurori A. Bajrami nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi.

26. Çështja në ngarkim të të pandehurve **I.L, E.L, Sh.S, N.B e Y. K**, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 260,259,278/3,245-25 , 244-25 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.79, datë 12.07.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin për masat e dënimit për të pandehurit I.L, E.L.

Prokurori B. Sheshi nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

27. Çështja në ngarkim të të pandehurve **A.M, Sh.M, B.C e E.S**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 ,22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurve

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.81, datë 17.07.2018, të Gjykates së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin duke ulur masat e dënimit për të pandehurit.

Prokurori B. Sheshi nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

28. Çështja në ngarkim të të pandehurës **V. Sh**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c, 22 e 23 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurës.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.102, datë 09.10.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin dhe e ka cilësuar veprën si plagosje e rëndë që ka shkaktuar vdekjen.

Prokurori B.Sheshi ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe nuk ka ushtruar rekurs.

29. Çështja në ngarkim të të pandehurit **L.B**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c e 22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit.

Gjykata e Apelit me vendimin nr.49 datë 17.04.2018 ,ka shpallur moskompetencën lëndore si gjykate jo kompetente për gjykimin e çështjes....kjo çështje duhej të gjykohej nga gjykata e nivelit të zakonshëm, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Kundër vendimit ka ushtruar Rekurs pranë Gjykatës së Lartë, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila kërkon: prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë.

Gjykata e Lartë ka vendosur: Dërgimin e akteve, Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda për vazhdimin e gjykimit që ka kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.21, datë 22.02.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin në lidhje me masën e dënimit duke e ulur nga 16 vjet burgim, në 11 vjet burgim.

Prokurori A.Bajrami nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

30. Çështja në ngarkim të të pandehurit **B.S**, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c e 22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr.05 date 18.01.2018, ka vendosur: Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit B. S, për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c e 22 të Kodit Penal, dhe caktimin ndaj tij të masës mjeksore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor".

Gjykata e Apelit me vendimin nr.38 datë 26.03.2018, ka shpallur moskompetencën lëndore si gjykate jo kompetente për gjykimin e çështjes....kjo çështje duhej të gjykohej nga gjykata e nivelit të zakonshëm, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Kundër vendimit ka ushtruar Rekurs, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënd, duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë.

Gjykata e Lartë ka vendosur: Dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda për vazhdimin e gjykimit që ka kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit nr.05 datë 18.01.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka prishur vendimin dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Prokurori A.Bajrami nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

**31. Çështja në ngarkim të të pandehurit G.Q,** akuzuar për vepren penale të parashikuar nga neni 283/a/1, 22 të Kodit Penal, ka ardhur me ankim të të pandehurit,

Nga prokurori i apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit Nr.112, datë 22.10.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe ka ulur masën e dënimit nga 6 vjet 4 muaj burgim në 5 vjet e 4 muaj burgim.

Prokurori A. Bajrami ka vlerësuar se nuk ka shkaqe për të ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi.

**III.4. Në shqyrtimin gjyqësor të çështjeve të ardhura me ankimin e të pandehurve, janë 21 vendime penale për të cilat është shpallur moskompetenca lëndore nga Gjykata e Apelit. Për këto vendime nga Prokurori është ushtuar Rekurs në Gjykatën e Lartë.**

Një aspekt tjetër i rëndësishëm mbetet edhe shqyrtimi i masave të sigurimit personal ku u jemi përmbajtur kriterëve dhe kërkesave sipas dispozitave për caktimin dhe vlerësimin e tyre.

Duke ju referuar kompetencës lëndore, në pamje të parë, duket i zgjidhur lloji i masës ekstreme të kërkuar nga prokurori në raport me rëndësinë e faktit dhe sanksionin e parashikuar, por mbetet e rëndësishme dhe ligjore ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova. Ky moment i rëndësishëm si një lloj i veçantë gjykimi, ndryshe nga shqyrtimi i çështjes në themel duhet të gjejë zgjidhje nga prokurori gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë. Përparësi në këtë drejtim merr argumentimi dhe arsyetimi me hollësi i kërkesës dhe shoqërimi i gjykimit me akte procedurale të hetimit paraprak sidomos veprimet e papërsëritshme që nxjerrin në pah ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Ky evidentim nuk ka për qëllim shmangien nga përgjegjësia gjatë përfaqësimit të tyre nga ana jonë, por janë shkaqe për cënimin e vendimit dhe riparimi i gabimeve në këtë fazë gjykimi vështirësohet, pasi dispozitat procedurale nuk të krijojnë hapësira të qarta për administrimin dhe paraqitjen e provave të reja në këtë fazë të gjykimit.

Në këtë këndvështrim, duke ju referuar statistikave rezulton se kërkesat dhe caktimi i masave të sigurimit personal u janë përmbajtur kushteve e kriterëve ligjore, kanë qenë të arsyetuara dhe jo me formularë tip si dhe të argumentuara përsa i përket ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm. Në raste të veçanta mangësish aktesh procedurale nga një bashkëpunim efektiv me Prokurorinë e Shkallës së Parë, është bërë e mundur plotësimi i fashikullit të gjykimit dhe moscënimi i vendimit.

**IV. Lidhur me masat e sigurimit personal në Gjykatë janë shqyrtuar 2 vendime mbi bazën e apelit të prokurorit, nga të cilat 1 ankim është pranuar nga Gjykata e Apelit.**

1- Me vendimin Nr.97, datë 12.05.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit për shtetasin **S. T** nga “arrest në burg” në atë të “Arrest në shtëpi”. Çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, mbi apelin e prokurorit dhe nga ana jonë nëpërmjet konkluzioneve përfundimtare është përkrahur apeli i prokurorit të shkallës së parë, duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për shtetasin S.T.

Në përfundim të gjykimit Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë **nuk e ka pranuar** kërkesën e prokurorit duke vendosur, shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Prokurori A. Bajrami ka ushtruar **Rekurs** në Gjykatën e Lartë

2- Me vendimin Nr.114, datë 05.07.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka vendosur të vleftësojë të paligjshëm ndalimin e shtetasit **G.D** dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, mbi apelin e prokurorit dhe nga ana jonë nëpërmjet konkluzioneve përfundimtare është përkrahur apeli i prokurorit të shkallës së parë. Në përfundim të gjykimit Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, **ka pranuar** kërkesën e prokurorit duke vendosur, ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

**Në rastet e masave të sigurimit personal, ardhur në Gjykatë me apelin e të pandehurve, Kolegji Gjyqësor i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ndryshuar vendimet si me poshte:**

1- Me vendimin Nr.38 datë 13.03.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit për shtetasit **M.Ç, H.Sh dhe A. S** “arrest në burg” edhe sipas kërkesës sonë. Kolegji Gjyqësor i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe ka caktuar “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për të pandehurit H.Sh dhe A.S.

Prokurori B. Sheshi, nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

2.Me vendimin Nr.96 datë11.05.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” , për shtetasit **K. A, A. Gj, N.M etj (19 shtetas)**, edhe sipas kërkesës sonë. Kolegji Gjyqësor i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ka lënë në fuqi vendimin me “arrest në burg”, për 17 shtetas dhe ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për dy shtetas nën hetim, A.Gj e N.M, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tyre.

Prokurori B. Sheshi, nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

3. Me vendimin Nr.99 datë 15.05.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasin **T.S.** Prokurori i Apelit në konkluzionin e tij kërkoi Miratimin e vendimit, për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e afatit 20 ditor për vazhdimin e masës së sigurimit

“arrest në burg”, për të garantuar marrjen e provës dhe saktësimin e kompetences. Kolegji Gjyqësor i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duke caktuar si masë sigurimi personal “Arrest në shtëpi” dhe deklarimin e moskompetencës së Gjykatës për Krime të Rënda dhe e ka dërguar çështjen në gjykatën kompetente, atë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Prokurori B. Sheshi, nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

4. Me vendimin Nr.157, datë 20.10.2018 dhe 158 datë 24.10.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe vazhdimin e zbatimit të masave të sigurimit për **44 shtetas**, edhe sipas kërkesës sonë.

Kolegji Gjyqësor i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe ka caktuar ndaj shtetasve të hetuar **E.G, A.Gj, A.Ç, A.N, P.S dhe Z.L**, masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale. Ndërsa për të hetuarit **L.Z.,L.P,V.N dhe G. Z**, Kolegji Gjyqësor i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe ka caktuar “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

**Vëmendje të posaçme në punën e Prokurorisë së Apelit i kemi kushtuar gjatë përfaqësimit në gjykim, edhe të çështjeve që kryesisht kanë të bëjnë me vendimet për revokim apo zëvendësim të masave të sigurimit dhe konkretisht:**

Për çështjet me objekt: **Zëvendësimin e masave të sigurimit** rezultojnë të jenë shqyrtuar **58** vendime nga të cilat, **53** janë miratuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

**IV.1. Për çështjet me objekt: Zëvendësimin e masave të sigurimit kemi dy çështje të ardhura me ankim të Prokurorit të shkallës së parë nga të cilat, nuk është pranuar apeli i prokurorit gjatë gjykimit për një çështje.**

1. Në çështjen në ngarkim të shtetasit nën hetim **M. H**, Gjykata e Apelit ka rrëzuar kërkesën e prokurorit të apelit i cili kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nga masa e vendosur “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, me masën e sigurimit “arrest në burg”.

2. Në çështjen në ngarkim të shtetasit nën hetim **D.Xh**, Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e prokurorit të apelit i cili kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nga masa e vendosur “Arrest në shtëpi”, me masën e sigurimit “arrest në burg”.

**IV.2. Gjatë shqyrtimit të çështjeve mbi bazën e ankimit të të pandehurve janë cënuar nga Gjykata e Apelit 4 vendime.**

1. Për vendimin penal Nr.02, datë 04.01.2018, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg” me masën e sigurimit “Garanci Pasurore”, në shumën 5.000.000 (pesë

milion) lekë dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, sipas neneve 236 dhe 234 të K.Pr.Penale, për të dyshuarin **O. S.**

Prokurori B. Sheshi, nuk ka ushtruar Rekurs kundër këtij vendimi

2. Për vendimin penal Nr.125, datë 11.10.2018, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg” në “arrest në shtëpi” për shtetasin nën hetim **A.Q.**

3. Për vendimin penal Nr.129, datë 17.10.2018, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg” në “arrest në shtëpi” për shtetasin nën hetim **F.L.**

4. Për vendimin penal Nr.147, datë 20.11.2018, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg” me masën e sigurimit “Garanci Pasurore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” ndaj të hetuarës **D.S.**

Për çështjet me objekt: **Revokimin e masave të sigurimit** rezultojnë të jenë shqyrtuar **11** vendime nga të cilat, **11** janë miratuar nga Gjykatë e Apelit për Krime të Rënda.

#### **V. Çështjet me objekt sekuestrim dhe konfiskim pasurie.**

Prokuroria e Apelit Për Krime të Rënda ka marrë pjesë në gjykimin e **8** çështjeve të kësaj natyre, nga të cilat në **7** raste janë lënë në fuqi vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë.

**V.1.** Në çështjen me **objekt konfiskimi** i pasurisë në ngarkim të shtetasit nën hetim **M.F.**, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.05, datë 16.03.2018, ka pranuar kërkesën e prokurorit të shkallës së parë për konfiskimin e pasurive në përdorim dhe në pronësi të shtetasit Mark Frroku dhe të familjarëve të tij siç janë: pasuri të paluajtshme të llojit truall, apartamente, dyqane, bodrum etj, dhe ka pushuar gjykimin për konfiskimin e pasurisë të llojit arë, me sipërfaqe 6000 m<sup>2</sup> të ndodhur në Lezhë, si dhe shuarjen e masës së sekuestrimit për këtë pasuri.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi **M.F.**, i cili kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

Prokurori i Apelit ka kërkuar: Ndryshimin e pjesës arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke përfshirë në shpenzimet e shtetasit **M.F.**, edhe shumën e dhënë hua shtetasve **A.M** e **N.K.**, në total shumën 550.000 Euro.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin Nr.143. datë 09.11.2018, ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për konfiskim, për disa nga këto pasuri të paluajtshme dhe ka rrëzuar kërkesën e prokurorit për konfiskimin e disa pasurive të tjera të paluajtshme.

**V.2.** Në çështjen me **objekt konfiskimi** i pasurisë në ngarkim të shtetasit nën hetim **Q. N.(T)**, dhe personave të tretë, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.29, datë 26.12.2017, ka pranuar pjesërisht padinë e prokurorit të shkallës së parë, për konfiskimin e një sipërfaqe prej 1153,34 m<sup>2</sup> në pjese ideale të pasurisë së



paluajtshme, në Dibër, duke i kaluar ajo në pronësi të shtetit dhe pjesa tjetër mbetet në pronësi të të pandehurit Q. N (T). Shuarjen e masës së sekuestrimit të sendeve të luajtshme, masë e marrë me vendim gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në vitin 2015, të inventarizuara në kuader të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, duke urdhëruar kthimin e tyre të paditurit Q.N (T).

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi Q. N (T) dhe personave të tretë të cilët kërkojnë, rrëzimin e kërkesës së prokurorisë dhe ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e këtij vendimi dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin Nr.123. datë 05.10.2018, e ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**V.3.** Në çështjen **me objekt konfiskimi** i pasurisë në ngarkim të shtetasve nën hetim **Sh. B, M.B** e personave të tretë, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.11, datë 18.05.2018, ka pranuar kërkesën e prokurorit të shkallës së parë, për konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pasurive të paluajtshme, objekt truall, objekt ndërtesë 5 katëshe, regjistruar në emër të Sh.B.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi Sh.B, dhe personat e tretë të cilët kërkojnë rrëzimin e kërkesës së prokurorisë dhe ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e këtij vendimi dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin datë 10.09.2018, e ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**V.4.** Në çështjen **me objekt sekuestrimi** i pasurisë në ngarkim të shtetasve **K.B e B.B,** Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.28, datë 21.11.2017, ka pranuar kërkesën e prokurorit të shkallës së parë dhe ka vendosur sekuestrimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme për (39 objekte) pasuri të llojit truall, objekte, apartamente.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi B. B dhe kërkon rrëzimin e kërkesës së prokurorisë dhe ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e këtij vendimi dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin Nr.11. datë 05.02.2018, e ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**V.5.** Në çështjen **me objekt sekuestrimi** i pasurisë në ngarkim të shtetasit **L.S,** Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.04, datë 05.03.2018, ka pranuar kërkesën e prokurorit të shkallës së parë dhe ka vendosur sekuestrimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme pasuri të llojit: truall, objekte, apartamente, makina dhe llogari bankare.

Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim shtetasit L.S dhe personat e tretë të cilët kërkojnë ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e këtij vendimi dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin Nr.49. datë 15.05.2018 ka vendosur: Mospranimin e ankimit të paraqitur nga shtetasi L.S, për shkak të heqjes dorë nga ankimi i paraqitur dhe ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**V.6.** Në çështjen me **objekt sekuestrimi** i një kamioni të shoqërisë “D. I” sh.p.k, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.298, datë 15.12.2017, ka rrëzuar kërkesën e palës ankuese, si të pambështetur në prova e në ligj.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shoqëria “D.I” sh.p.k, të cilët kërkojnë ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e këtij vendimi dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin Nr.03. datë 04.01.2018, e ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**V.7.** Në çështjen me **objekt Sekuestrimi** i pasurisë së paluajtshme, që i përkasin shtetasit A. Ll, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.179, datë 20.07.2018, ka pranuar kërkesën e prokurorit të shkallës së parë dhe ka vendosur sekuestrimin e pasurive të paluajtshme, pasuri të llojit apartament banimi, tokë arë.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi A.Ll dhe ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e këtij vendimi dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin Nr.84. datë 09.08.2018, ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**V.8.** Në çështjen me **objekt sekuestrimi** i pasurisë së paluajtshme që i përkasin shtetasve N,SH, A.Sh, A.Sh,K.Sh, V.Sh,B.Sh dhe K. Sh, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin Nr.21, datë 17.08.2018, ka pranuar kërkesën e prokurorit të shkallës së parë dhe ka vendosur sekuestrimin e pasurive

Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim kërkuarit dhe kanë kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e këtij vendimi dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin Nr.107, datë 17.09.2018, e ka miratuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Siç shihet nga kjo panoramë, në çështjet me objekt “sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive”, Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda i ka miratuar vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë. Ky është një tregues shumë domethënës në drejtim të cilësisë së hetimit pasuror të kryer dhe më tej edhe në drejtim të përfaqësimit sa më profesional të këtyre çështjeve para Gjykatës.

**VI.** Gjatë përfaqësimit të akuzës në gjykatë, Prokuroria e Apelit Për Krime të Rënda ka treguar kujdes të veçantë në drejtim të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor me qëllim shmangien e shkeljeve procedurale që kanë të bëjnë kryesisht me pjesëmarrjen e të pandehurit në gjykim, për shkak të mosmarrjes dijeni apo kryerjes së njoftimit sipas ligjit. Vëmendje e shtuar i është kushtuar jo vetëm përfaqësimit sa më dinjitoz të akuzës

në Gjykatë por edhe respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive të palëve në proces. Jemi përpjekur që “viktimës së veprës penale”, t’i garantohen të drejtat që parashikohen në nenin 58 të K.Pr.Penale.

Duke konsideruar ndryshimet që ka pësuar nenin 427 i K.Pr.Penale me Ligjin nr.35/2017, janë bërë të gjithë përpjekjet që kjo dispozitë të gjejë zbatim rast pas rasti.

Krahas angazhimit të mirëfilltë procedural penal, kujdes i është kushtuar marrëdhënieve dhe bashkëpunimit sa më efektiv me Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Pjesë e këtij bashkëpunimi kanë qenë diktatimet e herëpashershme lidhur me problematikën që lindte gjatë zhvillimit të gjyqimit të çështjeve në apel, shkëmbimin e informacionit apo dhe provave të nevojshme. Ky bashkëpunim i ka shërbyer qëllimit të prezantimit sa më të suksesshëm të çështjeve para Gjykatës së Apelit.

Mendoj se rritja e treguesve cilësorë gjatë përfaqësimit të akuzës në gjykatë, përgjithësimi i praktikës gjyqësore dhe evidentimi i dobësive të hetimit paraprak dhe përfaqësimit në gjykim do të mbeten prioritetet kryesore të punës sonë për vitin në vijim.

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**ALTIN DUMANI**